

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-621/023	Data: Datum: 30.06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010 të miratuar me datën 30.11.2010, për caktimin e Koordinatorit për zbatimin e Planit të Integritetit, nxjerr:

V E N D I M

Për caktimin e Koordinatorit për zbatimin e Planit të Integritetit

- 1. CAKTOHET:** Koordinaore për zbatimin e Planit të Integritetit **Delvina Sylaj** e sistemuar në punët dhe detyrat e punës Zyrtare për Personel 2.
- Obligohet koordinatorja e caktuar sipas pikës 1 të këtij Vendimi që punët e koordinatorës për zbatimin e Planit të Integritetit ti kryej dhe të bëjë raport.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Delvina Sylaj
- Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- znj.Delvina Sylaj dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-620/023	Data: Datum: 30.06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, dhe bazuar në Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, shqyrtoi kërkesën 01 Nr.400-17866 të datës 08.05.2023 të parashtruar nga OJQ “Folklori i Podgurit” të cilën e përfaqëson Ismet Demaj për përkrahje financiare, nxjerrë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 01 Nr.400-17866 e datës 08.05.2023 e parashtruar nga OJQ “Folklori i Podgurit” dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **500.00€ (pesëqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, për projektin: “Ta zbulojmë talentin e ri 2023”.

2. Obligohet OJQ “Folklori i Podgurit” të sjell dëshmi me foto dhe faturat për realizimin e projektit.

3. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e OJQ-së “Folklori i Podgurit” në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.

5. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ismet Demaj-OJQ “Folklori i Podgurit”,
- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-618/2023	Data: Datum: 29.06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e prokurimit të datës 27.06.2023, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Mirëmbajtja higjiene-sanitare e objekteve të komunës”, nxjerr:

V E N D I M

1. CAKTOHET: Menaxher i kontratës **z.Blerim Gërguri**, për projektin: “Mirëmbajtja higjiene-sanitare e objekteve të komunës”, me numër prokurimit 633-22-12114-2-2-1/C723 dhe me numër të brendshëm 633-022-080-221, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës **CAKTOHET: z.Arben Kabashi**, Drejtor i Drejtorisë për Administratë Komunale, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori ekonomik “**Selmans Network**” **SH.P.K** nga Prishtina

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.

3. Përgjegjësin për realizimin e projekteve të lartcekur e merr: Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Blerim Gërguri, Menaxhere e kontratës
- Arben Kabashi, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës-ZKA
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-617/2023	Data: Datum: 29.06.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 29.06.2023, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektet: Lot1 "Furnizimi me pajisje për kabinete të kimisë, biologjisë, gjeografisë dhe muzikës"; Lot2 "Blerja e ulëseve për shkollat e mesme"; Lot3 "Furnizimi me rekuizita sportive dhe institucionet shkollore"; Lot4 "Blerja e pajisjeve televizor për nevoja të shtëpisë për komunitete në Gurakoc", nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektet: Lot1 "Furnizimi me pajisje për kabinete të kimisë, biologjisë, gjeografisë dhe muzikës"; Lot2 "Blerja e ulëseve për shkollat e mesme"; Lot3 "Furnizimi me rekuizita sportive dhe institucionet shkollore"; Lot4 "Blerja e pajisjeve televizor për nevoja të shtëpisë për komunitete në Gurakoc", me numër të jashtëm prokurimi 633-023-5753-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-041-121 dhe në komision caktohen.

1.1. Naim Sadriu, Kryesuese e Komisionit;

1.2. Beqir Ibrahimaj, anëtar;

1.3. Brahim Hetemaj, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektet: Lot1 "Furnizimi me pajisje për kabinete të kimisë, biologjisë, gjeografisë dhe muzikës"; Lot2 "Blerja e ulëseve për shkollat e mesme"; Lot3 "Furnizimi me rekuizita sportive dhe institucionet shkollore"; Lot4 "Blerja e pajisjeve televizor për nevoja të shtëpisë për komunitete në Gurakoc", me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t'u ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

-Komisionit,

-Prokurimit,

-Drejtorisë Komunale për Arsim dhe

-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-616/2023	Data: Datum: 29.06.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 29.06.2023, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Ndërtimi i rrugës malore Zhakovë-Javor”, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Ndërtimi i rrugës malore Zhakovë-Javor”, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-5790-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-042-521 dhe në komision caktohen.

- 1.1. Vlbone Kaliqanaj,** Kryesuese e Komisionit;
- 1.2 Kaltrinë Kukleci,** anëtare;
- 1.3. Shefqet Imeraj,** anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e tenderit për projektin: “Ndërtimi i rrugës malore Zhakovë-Javor”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t'iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01Nr.615/023	Data Datum: 29.06.2023	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2020 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe bazuar në Raportin e Auditimit të Komunës së Istogut për vitin fiskal të përfunduar me 31 dhjetor 2022 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për themelimin e Grupit punues për hartimin e Planit të veprimit për eliminimin e të gjeturave të auditorit për vitin fiskal të përfunduar me 31 dhjetor 2022, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Grupi punues për hartimin e Planit të veprimit për eliminimin e të gjeturave të auditorit për vitin fiskal të përfunduar me 31 dhjetor 2022 dhe në Grup punues caktohen:

- 1.1. Genc Ademaj,** Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, Kryesues i Grupit Punues;
- 1.2. Osman Sadikaj,** Udhëheqës i Sektorit për Buxhet dhe Financa, ZKF, anëtar;
- 1.3. Arben Kabashi,** Drejtor i Drejtorisë për Administratë Komunale, anëtar;
- 1.4. Brahim Hetemaj,** Udhëheqës i Sektorit për Shëndetësi, anëtar;
- 1.5. Qendrim Ibrahimaj,** Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa, anëtar;
- 1.6. Shanije Buleshkaj,** Zyrtare e Pasurisë, anëtare.

2. Grupi punues do të bëjë hartimin e Planit të veprimit për eliminimin e të gjeturave të auditorit për vitin fiskal të përfunduar me 31 dhjetor 2022; do të njoftojë rregullisht Kryetarin me ecurinë e punës për hartimin e Planit të veprimit të caktuar me lartë dhe pas përfundimit kopjen e Planit të Veprimit do t'ia dorëzojë Kryetarit; do t'i kryejë edhe punët dhe përgjegjësit që janë në natyrën e këtij Grupi punues.

3. Grupi punues i lartcekur, ka për obligim që Planin e veprimit për eliminimin e të gjeturave të auditorit të hartoj për një kohë të shkurtë.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Grupi punues.

Vendimi i dërgohet:

- Grupit punues dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-591/2023	Data: Datum: 29.06.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 27.06.2023, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i hapësirave të jashtme në shkolla të komunës së Istogut (Bajram Curri, Trepça)”; Lot 2 “Ndërtimi i këndit të lojërave në parafillorët e shkollave fillore të komunës së Istogut”; Lot 3 “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme në SH.F. Bajram Curri në Dubravë”; Lot4 “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme në SH.F. Martin Camaj në Serbobran”, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i hapësirave të jashtme në shkolla të komunës së Istogut (Bajram Curri, Trepça)”; Lot 2 “Ndërtimi i këndit të lojërave në parafillorët e shkollave fillore të komunës së Istogut”; Lot 3 “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme në SH.F. Bajram Curri në Dubravë”; Lot4 “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme në SH.F. Martin Camaj në Serbobran”, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-5642-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-039-521 dhe në komision caktohen.

- 1.1. Naim Sadriu,** Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Hasan Blakaj,** anëtar;
- 1.3. Mimoza Kabashi,** anëtare.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i hapësirave të jashtme në shkolla të komunës së Istogut (Bajram Curri, Trepça)”; Lot 2 “Ndërtimi i këndit të lojërave në parafillorët e shkollave fillore të komunës së Istogut”; Lot 3 “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme në SH.F. Bajram Curri në Dubravë”; Lot4 “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme në SH.F. Martin Camaj në Serbobran”, me qellim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë Komunale për Arsim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-589/2023	Data: Datum: 26.06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nënin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nënin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nënin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe bazuar në nënin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, shqyrtoi kërkesën 12 Nr.400-20899 të datës 31.05.2023 të parashtruar nga Premtim Jahaj nga fsh.Rakosh për përkrahje financiare për organizimin e turnirit për nder të jetës dhe veprës të Labinot Aliaj dhe i propozoi Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 12 Nr.400-20899 e datës 31.05.2023 e parashtruar nga Premtim Jahaj, për përkrahje financiare për organizimin e turnirit për nder të jetës dhe veprës së Labinot Aliaj dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **500.00€ (pesëqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për pagesën e shpenzimeve si në projekt.

2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Premtim Jahaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Premtim Jahaj,
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-588/2023	Data: Datum: 26.06.2023	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe në bazë të nenit 9 të Rregullores MF 4/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.110/23 të datës 23.06.2023 të parashtruar nga Astrit Hajrizaj, Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të aplikimeve për ekspert të jashtëm vlerësues të projekteve të OJQ-ve nxjerr këtë:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni për shqyrtimin e ankesave të aplikimeve për ekspert të jashtëm vlerësues të projekteve të OJQ -ve, në përberje:

1.1.Fadil Kabashi, Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, kryesues

1.2.Arta Fetahu, Udhëheqëse e Sektorit për Zhvillim Ekonomik, anëtare

1.3.Brahim Hetemaj, Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë, anëtar

2. Komisioni për ankesa ka mandat të shqyrtojë ankesat e aplikimeve për ekspert të jashtëm të OJQ-ve, duke zbatuar Rregulloren MF 4/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

3. Komisioni për shqyrtimin e ankesave përbëhet nga 3, anëtarë dhe ka mandat 2 vjeçar.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për realizimin e tij do të kujdeset Komisioni për Ankesa, si dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi e Komunës së Istogut.

6. Vendimi është perfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

Komisionit për ankesa,
 Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
 Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ





 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-587/023	Data: Datum: 26.06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 23.06.2023 të pranuar me datën 26.06.2023, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektet: Lot1 “Furnizimi me buqeta lulesh dhe kurora për nevojat e Komunës se Istogut”, Lot2 “Furnizim me kurora të plastikes për nevojat e Komunës së Istogut” nxjerr:

V E N D I M

1.CAKTOHET: Menaxheri i kontratës **z.Ardon Arifaj**, Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave, për projektet: Lot1 “Furnizimi me buqeta lulesh dhe kurora për nevojat e Komunës se Istogut”, Lot2 “Furnizim me kurora të plastikes për nevojat e Komunës së Istogut” me numër prokurimit 633-23-3690-121/C721 dhe me numër të brendshëm 633-023-022-121, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës **CAKTOHET: z. Arben Kabashi**, Drejtor i Drejtorisë për Administratë Komunale, Lot 1 e ka fituar fituar për ta realizuar operatori ekonomik **N.T.N. “VISHI GARDEN”**; Lot 2 e ka fituar për ta realizuar operatori ekonomik **Shqiponje Beqiraj B.I.**

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Përgjegjësin për realizimin e projekteve të lartcekur e merr: Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Ardon Arifaj, Menaxher i kontratës
- Arben Kabashi, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës-ZKA
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-586/023	Data: Datum: 26.06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në bazë të nenit 68, 68.1 paragrafi 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën 01 Nr.553-24318 të datës 22.06.2023, të parashtruar nga Ukë Nikqi nga fsh. Saradran, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për hapjen e kanalit tek penda e cila është bllokuar për shkak të vërshimeve, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 01 Nr.553-24318 e datës 22.06.2023, e parashtruar nga Ukë Nikqi për përkrahje me karburant për hapjen e kanalit tek penda e cila është bllokuar për shkak të vërshimeve dhe përkrahet me **150 litra karburant**.
2. Obligohet Zyrtari i Transportit Ukë Nikqi të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant në pajtim me procedurat të cilat vlejnjë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Zyra e Kryetarit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Zyra e Kryetarit dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Ukë Nikqi, ka parashtruar kërkesën 01 Nr.553-24318 të datës 22.06.2023, për përkrahje me karburant për hapjen e kanalit tek penda e cila është bllokuar për shkak të vërshimeve ku ne si banor parcelojmë me fuqi punëtore për hapjen e kanalit, po në mungesë të mjeteve financiare kërkojmë përkrahje me karburant, ku do të përfundojnë punimet me vetë iniciativë dhe për kompensimin e demit të shkaktuar nga vërshimet, dhe përkrahet me **150 litra karburant**.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e Ukë Nikqit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Zyrtari i Transportit do ti pajisë me vërtetim për furnizim me karburante të lartpërmendur nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit në pajtim me procedurat që vlejnjë edhe për automjetet zyrtare. Shefi i Autoparkut do të kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ukë Nikqi
- Zyrës së Kryetarit dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
 z.Hir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 585 /023	Data: Datum: 23.06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58. pika b). të Ligjit 03/L 040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) , nenit 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) , Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës,(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.17/2011), dhe neni 1 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria Komunale e Arsimit shqyrtoi kërkesën 05.Nr-553-23593 të datës 16.06.2023 të parashtruar nga Bekim Hakaj nga fsh. Orroberdë për përkrahje me mjete financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për vajzën, Anduena Hakaj, dhe i propozoj Kryetarit që sipas shkresës 05.Nr.422/23 të datës 21.06.2023 të nxjerri:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.05-553-23593 e datës 16.06.2023, e parashtruar nga Bekim Hakaj për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për vajzën Anduena Hakaj dhe i ndahen 100.00€ (njëqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim si ndihmë momentale për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për gjysme vjetorin e dytë shkollor të vitit 2022/23, relacioni Orroberdë -Pejë dhe anasjelltas.
2. Pagesa e mjeteve të cekura, do të bëhet nga Drejtoria për Arsim dhe të njëjtat do të transferohen në xhirollogarinë e babait Bekim Hakaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Bekim Hakaj, ka parashtruar kërkesë Nr.05-553-23593 të datës 16.06.2023, me të cilën ka kërkuar që t'i ndahen mjete financiare për pagimin e shpenzimeve të udhëtimit për vajzën Anduena Hakaj si nxënëse të rregullt në IAAP "Rifat Gjota" në Pejë, për gjysme vjetorin e dytë të vitit shkollor 2022/23.

Bekimi e ka gjendjen e vështir ekonomike pasi që i njëjti ka edhe dy fëmijë të tjerë në shkollën fillore dhe kështu nuk ka mundësi për të gjithë që ti mbuloj shpenzimet e udhëtimit.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Arsim është përcaktuar edhe kodi ekonomik i subvencioneve dhe transvereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore, shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë të shoqatave joqeveritare dhe individëve.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogari e Bekim Hakaj, nga nëpunësi përgjegjës në Drejtorin për Arsim në pajtim me procedurat në fuqi.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Bekim Hakaj, Drejtorin për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqësja e sektorit Ligjor
 Znj. Zekije Sutaj



Kryetari i Komunës,
 Ilir Ferati



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-584/023	Data: Datum: 23.06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58. pika b). të Ligjit 03/L 040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) , nenit 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) , Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës,(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.17/2011), dhe neni 1 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria Komunale e Arsimit shqyrtoi kërkesën 05.Nr-553-6301 të datës 13.02.2023 të parashtruar nga Bukuriye Gashi nga fsh. Kërrninë, për përkrahje me mjete financiare për pagesën e shpenzimeve të transportit për djalin, Liridon Salijaj, dhe i propozoj Kryetarit që sipas shkresës 05.Nr.422/23 të datës 21.06.2023 të nxjerri:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 05.Nr-553-6301 të datës 13.02.2023, e parashtruar nga Bukuriye Gashi për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të transportit për djalin Liridon Salijaj dhe i ndahen 100.€ (njëqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transferove nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim si ndihmë momentale për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit në qendrën e Hendikosit në Istog .
2. Pagesa e mjeteve të cekura, do të bëhet nga Drejtoria për Arsim dhe të njëjtat do të transferohen në xhirollogarinë e Liridon Salijaj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

znj.Bukuriye Gashi, ka parashtruar kërkesë 05.Nr-553-6301 të datës 13.02.2023, me të cilën ka kërkuar përkrahje financiare për pagimin e shpenzimeve të transportit për djalin e saj Liridon Salijaj i cili trajtohet vazhdimisht në qendrën e Hindikosit në Istog. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Liridoni, është me aftësi të veçanta vijon trajtimin e vazhdueshëm në Hindikosë i njëjti udhëton çdo javë nga fsh. Kërrninë- Istog dhe anasjelltas.

Familja e Liridonit e ka gjendjen e vështirë ekonomike nuk ka burim tjetër të rregullt të të ardhurave dhe kështu nuk ka mundësi t'i mbulojë shpenzimet e udhëtimit.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Arsim është përcaktuar edhe kodi ekonomik i subvencioneve dhe transferove, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore, shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë të shoqatave joqeveritare dhe individëve.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogari të Liridon Salijaj nga nëpunësi përgjegjës në Drejtorin për Arsim në pajtim me procedurat në fuqi.


Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Bukuriye Gashi, Drejtoria për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije Sutaj




Kryetari i Komunës,
z. Ilir Ferati



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 583 /2023	Data: Datum: 23.06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Drejtorisë për Shëndetësi Nr.06-553-23787 të datës 19.06.2023, të parashtruar nga z.Armend Shoshaj, nga f.sh.Kashicë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e nënës së tij Gjejlane Shoshaj për marrjen e Kimioterapisë në Institutin Onkologjik në QKUK-së në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-23787 e datës 19.06.2023 e parashtruar nga z.Armend Shoshaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e nënës së tij Gjejlane Shoshaj për marrjen e Kimioterapisë në Institutin Onkologjik në QKUK-së në Prishtinë dhe i lejohen 60 litra karburant për 6 seanca.
2. Obligohet Zyrtari i Transportit që të pajisë z.Armend Shoshaj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Armend Shoshaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-23787 të datës 19.06.2023, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i nënës së tij në Institutin Onkologjik në QKUK-së në Prishtinë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Gjejlane Shoshaj, është i sëmurë dhe ka nevojë për marrjen e terapisë sipas raportit mjekësor dhe i ndihmohet me 60 litra karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj në për marrjen e Kimioterapisë në Prishtinë.

I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj në Prishtinë për marrjen e terapisë- Kimioterapisë.

Zyrtari i transportit do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Armend Shoshaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
 z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-582/023	Data: Datum: 23.06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58, pika b të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 18 paragrafi 4 të Ligjit NR.06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, nenin 49 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 90/2010), shqyrtoi kërkesën 01 Nr.016-23413 të datës 15.06.2023 të parashtruar nga Fjollë Berisha nga fsh. Cërrrcë, për lejin e pushimit të lehonisë, nxjerr:

V E N D I M

1.MIRATOHET: kërkesën 01 Nr.016-23413 e datës 15.06.2023 e parashtruar nga Fjollë Berisha, Zyrtare për e lartë e personelit nga data 13.06.2023, i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje për 9 muaj.

2. Pushimi, i cekur në pikën 1 të këtij Vendimi ka filluar me:13.06.2023 deri më:13.03.2024, e përmendura duhet të lajmërohet në punë me: 28.01.2024

3. Në 6 muajt e parë të pushimit të lehonisë prej datës 13.06.2023 deri me datën 13.12.2023 kompensohet nga institucioni me 70% të pagës dhe me datën 13.12.2023, obligohet Zyrtarja Financiare-përgjegjëse për paga, mëditje dhe kompensime që Fjollën të vendos në listën e pagave me zero (0).

4. Mbas gjashtë muajve Fjollë Berisha mund të paraqes kërkesë Qeverisë së Republikës së Kosovës për 3 muajt në vijim për kompensim me 50% të pagës mesatare në Kosovë si dhe 3 muaj tjerë pa pagesë mund ti lejohen vetëm me kërkesën e të punësuarës.

A r s y e t i m

Fjollë Berisha, Zyrtare e lartë e personelit, ka parashtruar kërkesë 01 Nr.016-23413 të datës 15.06.2023 për lejin e pushimit të lehonisë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të lartpërmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 9 muaj.

Në pajtim me nenin 49 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010) punëtores i takojnë 6 muaj pushim të lehonisë me pagesë 70% të pagës së marr nga institucioni ku punon, mirëpo nëse donë të kthehet në punë mbas gjashtë muajve është e obliguar që më së voni 15 ditë para përfundimit të pushimit gjashtë muaj të njoftoj: Menaxherin e Personelit se nuk dëshiron të shfrytëzoj pushimin e përcaktuar në kohëzgjatje prej 3 muajve që paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Zyrtarja Financiare-përgjegjëse për paga mëditje dhe kompensime obligohet që pas gjashtë muajve të pushimit të lehonisë zyrtaren e lartpërmendur të vendos në listën e pagave me zero(0) dhe e lartpërmendura pas 9 muajve obligohet të njoftoj institucionin për ndërprerjen e pushimit të lehonisë apo parashtron kërkesë për vazhdimin e pushimit të lehonisë edhe tre muaj pushim pa pagesë.

Për realizimin e pagës në kohëzgjatje prej 3 muajve përmes MPMS-së e lartpërmendura duhet personalisht t'i drejtohet Entit të Punësimit për realizimin e kësaj pagese.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Fjollë Berisha,
- Zyrtares Financiare-përgjegjëse për paga, mëditje dhe kompensime,
- Menaxherit të Personelit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
 z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-581/2023	Data: Datum: 23.06.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62 i miratuar me datën 30.11.2010, dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, miratohet kërkesa e parashtruar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale 06Nr.138/2023 e datës 20.06.2023, për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: Kërkesa 06Nr.138/2023 e datës 20.06.2023, e parashtruar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale, për ndarjen e mjeteve buxhetore për pako ushqimore për familjet në nevojë në shumë prej **5,000.00€ (pesë mijë euro)** nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.

2. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

3. Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Mirëqenie Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-580/023	Data: Datum: 22.06.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 21.06.2023 për formim të komisionit për verifikimin e punëve për projektin: “Ndërtimi i Ambulancës në fshatin Veriq” me numër të jashtëm prokurimi 633-22-5241-5-2-1/ C573 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-020-521 dhe nxjerr:

V E N D I M

1.FORMOHET: Komisioni për verifikimin e punëve për projektin: “Ndërtimi i Ambulancës në fshatin Veriq” me numër të jashtëm prokurimi 633-22-5241-5-2-1/C573 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-020-521 të cilin e ka realizuar operatori “**AAG PROJEKT**” SH.P.K’, **Rruga Agim Ramadani-Prishtinë** dhe në komision caktohen:

- 1.1. Hekuran Rugova**, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. Blerim Bujupi**, anëtar dhe;
- 1.3 Albert Hasanaj**, anëtar

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj mbikëqyrësin e punimeve, do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartëcekur; do të hartojë procesverbalin për verifikimin e punimeve si dhe do t’i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Komisioni dhe Drejtoria për Shëndetësi.

4. Vendimi është perfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe,
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-578/023	Data: Datum: 21.06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, dhe bazuar në Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, shqyrtoi kërkesën 01 Nr.400-19814 të datës 22.05.2023 të parashtruar nga OJQ “Folklori i Podgurit” të cilën e përfaqëson Ismet Demaj për përkrahje financiare, nxjerrë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 01 Nr.400-19814 e datës 22.05.2023 e parashtruar nga OJQ “Folklori i Podgurit” dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **500.00€ (pesëqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, për projektin: “Manifestimi e 1 Qershorit dita ndërkombëtare e fëmijëve”.

2. Obligohet OJQ “Folklori i Podgurit” të sjell dëshmi me foto dhe faturat për realizimin e projektit.

3. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e OJQ-së “Folklori i Podgurit” në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ismet Demaj-OJQ “Folklori i Podgurit”,
- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-577/2023	Data: Datum: 21.06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 19.06.2023 të pranuar me datë 21.06.2023 për çaktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Trajtimi Kastrimi dhe Sterilizimi i Qeneve Endacak”, nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** Menaxher i kontratës: **z.Hekuran Rugova**, Arkitekt dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës **CAKTOHET: z.Xhevat Demaj**, Drejtor i Drejtorisë për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim, për projektin: “Trajtimi Kastrimi dhe Sterilizimi i Qeneve Endacak”, me numër të jashtëm prokurimi 633-23-4035-2-2-1/C718 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-023-027-221, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar **“HAKI BYTÇI” B.I.**
1. **MIRATOHET:** kërkesa 06.Nr.553-13005 e datës 03.04.2023 e parashtruar nga Zeqir Blakaj nga fsh. Vrellë , për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **100.00€ (njëqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim (Terapi).
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Zeqir Blakaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Zeqir Blakaj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-13005 të datës 03.04.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Zeqiri është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **100.00€(njëqind euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi është përcaktuar edhe pozicioni i subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Zeqir Blakaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Zeqir Blakaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-542/023	Data: Datum: 14.06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve, shqyrtoi kërkesën 01Nr.553-23087 të datës 13.06.2023 të parashtruar nga Ansambli Folklorik "Selmon Kadria" të cilën e përfaqëson Ismet Demaj, për përkrahje me karburant dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 01Nr.553-23087 e datës 13.06.2023 e parashtruar nga Ansambli Folklorik "Selmon Kadria" të cilën e përfaqëson Ismet Demaj dhe përkrahjet me **50 litra karburant** për pesë vetura nga 10 litra karburant për secilin, për pjesëmarrje të Ansambli Folklorik "Selmon Kadria" në Festivalin Folklorik "Eshkë e ndezur mbi Shkëlzen" i cili është tradicional dhe organizohet në Komunën e Deqanit.

Angazhet Zyrtari i Transportit të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant Ansambli Folklorik "Selmon Kadria", në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Zyra e Kryetarit dhe Zyrtari i Transportit.

4. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ismet Demaj- Ansambli Folklorik "Selmon Kadria",
- Zyrtari i Transportit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-538/2023	Data: Datum: 12.06.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 09.06.2023, të pranuar me datë 12.06.2023, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektet: “Mirëmbajtja e Objekteve në Institucionet Komunale (Administratën Komunale, Objektet Shëndetësorë, Objektet Arsimore, Objektet Sociale dhe Rezidenciale dhe Objektet Kulturore)” me numër të jashtëm prokurimi 633-23-4969-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-035-121 , nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Mirëmbajtja e Objekteve në Institucionet Komunale (Administratën Komunale, Objektet Shëndetësorë, Objektet Arsimore, Objektet Sociale dhe Rezidenciale dhe Objektet Kulturore” me numër të jashtëm prokurimi 633-23-4969-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-035-121 dhe në komision caktohen.

- 1.1. **Brahim Hetemaj**, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Naim Sadriu**, anëtar;
- 1.3. **Shfqet Imeraj**, anëtar.

2. Komisioni i cetur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Mirëmbajtja e Objekteve në Institucionet Komunale (Administratën Komunale, Objektet Shëndetësorë, Objektet Arsimore, Objektet Sociale dhe Rezidenciale dhe Objektet Kulturore” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shëndetësi, Drejtoria Komunale për Arsim, Drejtoria për Administratë Komunale.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Shëndetësi, Drejtorisë Komunale për Arsim, Drejtorisë për Administratë Komunale dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-537/2023	Data: Datum: 12.06.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 12.06.2023, të pranuar me datë 12.06.2023, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Renovimi i objekteve të zjarrfikësve në Dushkajë-Istog” me numër të jashtëm prokurimi 633-23-5044-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-029-521 , nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Renovimi i objekteve të zjarrfikësve në Dushkajë-Istog” me numër të jashtëm prokurimi 633-23-5044-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-029-521 dhe në komision caktohen.

- 1.1. **Sadik Kovačović**, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Tahir Maksutaj**, anëtar;
- 1.3. **Hekuran Rugova**, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Renovimi i objekteve të zjarrfikësve në Dushkajë-Istog”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim .

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
 z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-536/2023	Data: Datum: 12.06.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 09.06.2023, të pranuar me datë 12.06.2023, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Mirëmbajtja e E-kioskave” me numër të jashtëm prokurimi 633-23-5015-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-011R-221 , nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Mirëmbajtja e E-kioskave” me numër të jashtëm prokurimi 633-23-5015-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-011R-221 dhe në komision caktohen.

- 1.1. **Faton Bujupi**, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Agim Pacaj**, anëtar;
- 1.3. **Vlora Gjoci**, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Mirëmbajtja e E-kioskave”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t'iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Administratë Komunale.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Administratë Komunale dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
 z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-535/2023	Data: Datum: 12.06.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 12.06.2023, të pranuar me datë 12.06.2023, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i trotuarit Lubove-Banjë” Lot.2 “Ndërtimi i trotuarit Dubravë”, Lot.3 “Ndërtimi i trotuarit kodër e Tomocit-poligon sportiv” Lot.4 “Ndërtimi i trotuarit në Shushicë të Epërme-shkolla” me numër të jashtëm prokurimi 633-23-4560-5-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i trotuarit Lubove-Banjë” Lot.2 “Ndërtimi i trotuarit Dubravë”, Lot.3 “Ndërtimi i trotuarit kodër e Tomocit-poligon sportiv” Lot.4 “Ndërtimi i trotuarit në Shushicë të Epërme-shkolla” me numër të jashtëm prokurimi 633-23-4560-5-2- dhe në komision caktohen.

- 1.1. **Blerim Bujupaj**, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Naser Nimanaj**, anëtar;
- 1.3. **Albert Hasanaj**, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i trotuarit Lubove-Banjë” Lot.2 “Ndërtimi i trotuarit Dubravë”, Lot.3 “Ndërtimi i trotuarit kodër e Tomocit-poligon sportiv” Lot.4 “Ndërtimi i trotuarit në Shushicë të Epërme-shkolla” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
 zllir FERATI



	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Nr.Br.01-534/023	Data: Datum: 09.06.2023	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 8 paragrafi 3, pika 3.2 të Rregullores MF 4/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, shqyrtoj kërkesën 09.Nr.89/2023 të datës 08.06.2023 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe vlerësimin e aplikacioneve për ekspert të jashtëm, të cilët kanë aplikuar në thirrjen publike të datës 07.06.2023, për të qenë pjesë e komisionit vlerësues të projekteve të OJQ-ve, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për anëtar të komisionit për ekspert të jashtëm sipas thirrjes publike të datës 07.06.2023, për të qenë pjesë e komisionit vlerësues dhe në komision caktohen:

- 1.1. Qendrim Kajtazaj,** Kryesuese e komisionit;
- 1.2. Egzon Kabashi,** anëtar;
- 1.3. Gentritha Salihaj,** anëtare,

2. Komisioni i cekur me lartë ka për obligim që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve të cilët kanë aplikuar për të qenë pjesë e komisionit vlerësues për ekspert të jashtëm sipas thirrjes publike të datës 07.06.2023 si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

4. Vendimi është përfundimtar

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-533/2023	Data: Datum: 09.06.2023	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 11 të Rregullores 01.Nr 54/2021 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim me pak se një vit të pronës së paluajtshme komunale të miratuar me datë 31.05.2021, shqyrtoj kërkesën e datës 07.06.2023 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis, për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni për shqyrtimin e ankesave për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike në kompetencë të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis dhe në Komision caktohen:

- 1.1. Gazmend Sadrijaj,** Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Rexhep Blakaj,** anëtar;
- 1.3. Elfete Blakaj,** anëtare;
- 1.4. Naser Nimanaj,** anëtar;
- 1.5. Berat Hasanaj,** anëtar;

2. Komisioni i cekur më lartë ka për obligim që të bëjë shqyrtimin e të gjitha ankesave të parashtruara për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis, bazuar në dispozitat e të Rregullores 01.Nr 54/2021 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim me pak se një vit të pronës së paluajtshme komunale; do të njoftojë Kryetarin lidhur me punën e Komisionit si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit e tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Komisioni për shqyrtimin e ankesave ka mandat dy vjeçar.

4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për realizimin e tij do të kujdeset Komisioni dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-532/2023	Data: Datum: 09.06.2023	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 7 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1. dhe nenin 10 të Rregullores 01.Nr 54/2021 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim me pak se një vit të pronës së paluajtshme komunale të miratuar me datë 31.05.2021, shqyrtoj kërkesë e datës 07.06.2023 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis, për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike në kompetencë të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike në kompetencë të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis dhe në Komision caktohen:

- 1.1. Afrim Metaj,** Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Rustem Gashi,** anëtar;
- 1.3. Agim Pacaj,** anëtar;

2. Komisioni i cekur më lartë ka për obligim që të bëjë shqyrtimin e të gjitha kërkesave për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike në kompetencë të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis, bazuar në dispozitat e Rregullores 01.Nr 54/2021, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim me pak se një vit; do të njoftojë Kryetarin lidhur me punën e Komisionit si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit e tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike ka mandat dy vjeçar.

4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për realizimin e tij do të kujdeset Komisioni dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-531/023	Data: Datum: 09.06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 34 paragrafin 12 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2019) dhe bazuar në nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shqyrtoi kërkesën me 02Nr.123/2023 të datës 06.06.2023 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për themelimin e Komisionit të pranimit për zhvillimin e procedurave të rekrutimit, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 02Nr.123/2023 e datës 06.06.2023, e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për themelimin e Komisionit të pranimit për zhvillimin e procedurave të rekrutimit-pranim në kategori **për pozitën: Teknik i Pylltarisë për Mbrojtje dhe Monitorim** në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, sipas konkursit të publikuar me datën 25.04.2023 dhe Komisioni i pranimit themelohet me këtë përbërje si me poshtë:

- 1.1. **Fisnik Shoshaj**, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Daut Kabashi**, anëtar;
- 1.3. **Qesere Ibrahimaj**, anëtare,
- 1.3. **Enisa Ćorović**, anëtare,
- 1.5. **Haxhi Metaj**, Ekspert i Jashtëm, anëtar.

Anëtar rezervë:

- 1.1. **Fadil Kabashi**, anëtar,
- 1.2. **Vallbonë Kaliqanaj**, anëtare,
- 1.3. **Xhevat Idrizaj**, anëtar,
- 1.4. **Esad Smakić**, anëtar,
- 1.5. **Haxhi Metaj**, Ekspert i Jashtëm, anëtar.

3. Punët e Komisionit të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L -114 për Zyrtarët Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do ti kryejë Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e kujdeset Komisioni.

6. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit të pranimit;
- Zyrës Personelit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
Z. HIR FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-529/023	Data: Datum: 09.06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, bazuar në Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, shqyrtoj kërkesën 01 Nr.400-19159 të datës 17.05.2023 të parashtruar nga organizata e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara "OPFAKOS", dega në Istog me përfaqësues z. Enver Boletini për përkrahje financiare për pjesëmarrje në kampin Rehabilitues në Rugovë nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 01 Nr.400-19159 e datës 17.05.2023, e parashtruar nga OJQ "OPFAKOS" dega në Istog, për përkrahje financiare dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere-programi buxhetor i Zyrës për barazi gjinore, për pagesën e shpenzimeve të transportit dhe ushqimit, për pjesëmarrjen në Kampin Rehabilitues të organizuar në Rugovë me rastin e ditës së personave me aftësi të kufizuara.
- Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e përfaqësuesit të OJQ-"OPFAKOS", z. Enver Boletini, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyra e Kryetarit.
- Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- OJQ "OPFAKOS",
- Zyra e Kryetarit dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br. <u>528</u> /2023	Data: Datum: <u>09 . 06 . 2023</u>	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-10631 të datës 15.03.2023, të parashtruar nga Sabajeta Šabotić nga fshati Lubovë, Komuna e Istogut, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-10631 e datës 15.06.2023, e parashtrueses Sabajeta Šabotić, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozimin e Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **300.00 € (treqind euro)**, nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, kategoria ekonomike subvencione e transfere, si ndihmë momentale për shërim.
- Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Sabajeta Šabotić, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
- Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
- Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Sabajeta Šabotić, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-10631, me datë 15.03.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.
Kryetari shqyrtoi propozimin e komisionit për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.
Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Sabajeta është e sëmurë dhe ka nevojë për blerjen e terapisë për shërim, e cila është mjaftë e kushtueshme.
E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave, kjo i pamundëson që me mjete vetanke të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **300.00 € (treqind euro)**.
Në plan programin buxhetor të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.
Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Sabajeta Šabotić, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike.
Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Sabajeta Šabotić,
- Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije Sutaj,





 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br. <u>527</u> /2023	Data: Datum: <u>09</u> .06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014. Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-15610 të datës 24.04.2023, të parashtruar nga Vesel Zymeraj, nga fshati Serbobran, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për përkrahje me lëndë djegëse (karburant), për dërgimin e saj në QKUK në Prishtinë, të nxjerr:

V E N D I M

- APROVOHET:** kërkesa Nr.06-553-15610 e datës 24.04.2023, e parashtruesit Vesel Zymeraj, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant) për dërgimin e saj në QKUK në Prishtinë, për marrjen e terapisë mjekësore (Kemio - terapi), në relacionin Istog - Prishtinë dhe anasjelltas, i lejohen 100 litra lëndë djegëse (karburant) për 10 seanca.
- Obligohet Zyrtari i Transportit, që të pajisë Vesel Zymeraj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
- Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Vesel Zymeraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-15610 të datës 24.04.2023, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i tij. Kryetari e shqyrtoi propozimin e komisionit për të përmendurin dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Vesel Zymeraj, është i sëmurë dhe i ndihmohet me lëndë djegëse (karburant) për mbushjen e veturës, për dërgimin e saj për marrjen e Kemio terapisë në QKUK në Prishtinë.

I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij në Prishtinë për marrjen e kemio terapisë.

Zyrtari i Transportit, do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtoria për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Vesel Zymeraj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br. <u>526</u> /2023	Data: Datum: <u>09.06.2023</u>	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014. Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-21052 të datës 01.06.2023, të parashtruar nga Gjylsha Zeqiraj, nga fshati Studenicë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për përkrahje me lëndë djegëse (karburant), për dërgimin e saj në QKUK në Prishtinë, të nxjerr:

V E N D I M

- 1. APROVOHET:** kërkesa Nr.06-553-21052 e datës 01.06.2023, e parashtrueses Gjylsha Zeqiraj, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant) për dërgimin e saj në QKUK në Prishtinë, për marrjen e terapisë mjekësore (Kemio-terapi), në relacionin Studenicë - Prishtinë dhe anasjelltas, i lejohen 100 litra lëndë djegëse (karburant) për 10 seanca.
- Obligohet Zytari i Transportit, që të pajisë Ramiz Zeqiraj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zytari i Transportit.
- Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Gjylsha Zeqiraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-21052 të datës 01.06.2023, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj. Kryetari e shqyrtoi propozimin e komisionit për të përmendurin dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Gjylsha Zeqiraj, është e sëmurë dhe i ndihmohet me lëndë djegëse (karburant) për mbushjen e veturës, për dërgimin e saj për marrjen e kimioterapisë në QKUK në Prishtinë.

E lartpërmendura nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj në Prishtinë për marrjen e kemio-terapisë.

Zytari i Transportit, do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtoria për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Gjylsha Zeqiraj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zytarit të Transportit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Nr.Br.01-525/023	Data Datum: 09.06.2023	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj aprovimin e Prokurimit i cili aprovon kërkesën e datës 09.06.2023 të parashtruar nga Fadil Kabashit, për zëvendësim të Kryesuesit të Komisionit sipas Vendimit 01Nr.416/2023 të datës 19.05.2023 për vlerësimin e tenderit Nr.633-0234134-1-6-10, nxjerr:

V E N D I M

1.MIRATOHET: aprovimin Prokurimit i cili aprovon kërkesën e datës 09.06.2023 të parashtruar nga Fadil Kabashit, për zëvendësim të Kryesuesit të Komisionit sipas Vendimit 01Nr.416/2023 të datës 19.05.2023 për vlerësimin e tenderit për projektet: Shitja e masës drunore të zjarrit dhe teknik-Lot1 “Dru të konfiskuara-Sine”; Lot2 “Shitja e masës drunore në njësinë menaxhuese Radusha ngastra NR.45/ në ngastra 061,062,069,070,071”; LOT3--“Shitja e masës drunore në njësinë menaxhuese Lugu i Butë ngastra NR.45/ në ngastra 02,05; LOT4--“Shitja e masës drunore në njësinë menaxhuese Lugu i Butë ngastra NR.46/ në ngastra 01,04,05,06, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-4134-1-6-10 dhe caktohet: **Daut Kabashi, Kryesues i Komisionit.**

2. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Daut Kabashi, Prokurimi dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

3. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Prokurimit,
- Komisionit,
- Daut Kabashit,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-524/023	Data: Datum: 09.06.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 35 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2. dhe 1.3. neni 36 paragrafi 2 nenparagrafi 2.3., 2.5. të Ligjit Nr.08/L-196 për pagat në Sektorin Publik dhe bazuar në nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për Kompensimin për kujdestari, punë gjatë natës dhe punës jashtë orarit të punës, bazuar në formularët për punën jashtë orarit të rregullt të punës të nënshkruar nga Kryetari i Komunës, nxjerr:

V E N D I M

1. KOMPENSOHET: Valbone Kaliqanaj, Zyrtare e Lartë për Pemëtari, e cila ka punuar për aplikimin e fermerëve për subvencione jashtë orarit të rregullt të punës, e që për 13 orë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës me 30% kompensohet në shumë prej 58.24€ (pesëdhjetë e tetë euro e njëzetë e katër cent), për punë gjatë fundjavës me 50% kompensohet në shumë prej 41.36€ (katërdhjetë e një euro e tridhjetë e gjashtë cent), e që gjithsejtë kompensohet në shumë të përgjithshme **99.60€ (nëntëdhjetë e nëntë euro e gjashtëdhjetë cent).**

2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e **Valbone Kaliqanaj**, nga kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave publike dhe të përgjegjësi.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe Zyrtarja Financiare-përgjegjëse për paga Mëditje dhe Kompensime.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Valbone Kaliqanaj,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi
- znj.Emina Coković, Zyrtare Financiare-përgjegjëse për paga Mëditje dhe Kompensime dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-521/023	Data Datum: 08.06.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në Statutit e Komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj procesverbalin e datës 07.06.2023 të hartuar nga Komisioni intervistues për pozitën: Udhëheqës i Sektorit për Mirëqenie Sociale i themeluar me Vendim 01Nr.372/2023 të datës 10.05.2023 dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: procesverbali i datës 07.06.2023 i hartuar nga Komisioni intervistues i themeluar me Vendim 01Nr.372/2023 të datës 10.05.2023 për pozitën: Udhëheqës i Sektorit për Mirëqenie Sociale në kuadër të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, bazuar në procesverbalin 07.06.2023 të hartuar nga Komisioni intervistues, Myrvete Verbaj, Udhëheqëse e Sektorit për Shërbime Sociale nuk do të jetë pjesë e Komisionit për intervistimin me gojë të kandidatëve dhe në vend të saj caktohet **Haki Ibrahimaj**, Drejtor i Qëndresë për Punë Sociale, Komisioni ka përbërjen si me poshtë:

- 1.1. Zizë Bujupaj**, E emëruar-Menaxher i Personelit-NJMBNJ, Kryesuese e Komisionit;
- 1.2. Haki Ibrahimaj**, Drejtor i Qëndresë për Punë Sociale, anëtare dhe;
- 1.3. Rasim Mahmutović**, Udhëheqës i Sektorit për Komunitet dhe Kthim, anëtar;

3. Punët e Komisioni të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do ti kryejë Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij kujdeset Komisioni.

6. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Myrvete Verbaj,
- Haki Ibrahimaj,
- Zyrës Personelit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-520/023	Data: Datum: 08.06.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 nenin 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2020 i miratuar me datë 30.11.2010, sipas kërkesës së z.Kushtrim Buleshkaj, Drejtor i Drejtorisë për Inspektion për lejimin e pushimit vjetor, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa e **z.Kushtrim Buleshkaj**, i emëruar Drejtor i Drejtorisë për Inspektion për lejimin e pushimit vjetor.
2. Të lartpërmendurit i lejohet shfrytëzimi i pushimin vjetor nga 28.07.2023 deri me datën 07.08.2023.
3. Punës mund t'ia filloj nga data 09.08.2023
4. Ky Vendim është përfundimtar dhe hynë në fuqi menjëherë pas nënskkrimit dhe për zbatimin e tij kujdeset: z.Kushtrim Buleshkaj.

Vendimi i dërgohet:

- z.Kushtrim Buleshkaj dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-519/2023	Data: Datum: 08.06.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 02.06.2023, të pranuar me datë 07.06.2023, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: Lot1 “Servisimi i automjeteve të zjarrfikëseve” me numër të jashtëm prokurimi 633-23-4429-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-030-221, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: Lot1 “Servisimi i automjeteve të zjarrfikëseve ” me numër të jashtëm prokurimi 633-23-4429-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-030-221 dhe në komision caktohen.

- 1.1. Tahir Maksutaj,** Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Sadik Kovaćović,** anëtar;
- 1.3. Bashkim Haxhijaj,** anëtar.

